



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Emri i dokumentit strategjik:

PLANI I VEPRIMIT PËR PERIUDHEN TRE VJEÇARE 2016-2018
PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË TRAJNIMIT TË NËPUNËSVE CIVILË 2016-2020

Prishtinë, nëntor 2015

<p>Informacionet themelore në këtë dokument të strategjisë janë në përputhje me Nenin 9 të Udhëzimit Administrativ - UA nr. 02/2012 i Qeverisë së Kosovës.</p>	
1.	<p>Përshkrimi i dokumentit të propozuar të strategjisë: Plani i Veprimit për Strategjinë e Trajnimit të Nëpunësve Civil ka për qëllim krijimin e masës kritike të nëpunësve civil të trajnuar profesionalisht me njohuri dhe aftësi të përshtatshme që do ta sjellin Kosovën më afër shteteve anëtare të BE-së dhe integrimin në këto struktura të propozuara.</p>
2.	<p>Cili prioritet i qeverisë do të trajtohet në këtë strategji? Plani i Veprimit është dokumenti ekzekutiv i strategjisë së përmendur më lartë. Të dyja dokumentet do të kenë parasysh ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civil, në përputhje me Nenet 33, 35, paragrafi 3 dhe Nenin 58 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil.</p>
3.	<p>Pse nevojiten dokumentet e propozuara të strategjisë? Arsyeja kryesore për trajnimin e nëpunësve civil në Kosovë është për ndërtimin e një administrate moderne, profesionale dhe kompetente në nivelin qendror dhe lokal, e cila ofron shërbime kualitative publike për qytetarët dhe subjektet ligjore.</p>
4.	<p>Vitet për zbatimin e planit të veprimit: Ky plan i veprimit për nëpunësit civil do të zbatohet gjatë periudhës kohore 2016 - 2018, përkatësisht gjatë tri viteve. Dokumenti kryesor, Strategjia për Trajnimin e Nëpunësve Civil, është propozuar për periudhë më të gjatë kohore 2016-2020. Pas vlerësimit dhe rishikimit të zbatimit të këtij plani (të parë) të veprimit në fund të periudhës tri vjeçare, përgatitet plani (i dytë) i veprimit.</p>
5.	<p>Ndërlidhja me PVPE, nëse ka: Plani i Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (PVMSA), 2015, pika 91 dhe SAA.</p>
6.	<p>Ndërlidhja me dokumentet tjera strategjike:</p>

	Strategjia do të marrë parasysh dokumentet strategjike qeveritare, si Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 dhe Planin e Veprimit për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2017.
7.	A ka pasur strategji paraprake që ka trajtuar këtë çështje? Strategjia paraprake e trajnimit 2011-2013 ka skaduar në vitin 2013.
8.	<p>Palët e përfshira të interesit, duket përfshirë ministrinë tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Administratës Publike, Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil (MAP, DASHC) – institucioni kryesor për koordinimin e Planit të Veprimit; - Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) – institucioni kryesor për zbatimin e Planit të Veprimit; - Zyra e Kryeministrit, Zyra për Planifikim Strategjik (ZKM, ZPS); - Ministria e Financave (MF); - Ministria e Integritimit Evropian (MIE); - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL); - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT); - Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) <p>Ministritë dhe institucionet qeveritare të sipërpërmendura kanë emërtuar anëtarë të Grupin të Veçantë Punues Ndërmintor për Përpilimin e Strategjisë për Trajnimin e nëpunësve Civil dhe Planit të Veprimit për këtë strategji sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MAP-it, datë 3 nëntor 2014, Nr. 5693, dhe - Vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MAP-it, datë 9 nëntor 2015, Nr. 107.
9.	<p>Përfshirja e pritur e donatorëve, qoftë në hartimin e Planit të Veprimit për strategjinë apo në financimin e saj:</p> <p>Implementimi i këtij dokumenti do të kërkonte financim nga Buxheti i Kosovës (më tutje në këtë dokument BK). Në BK-në e aprovuar për vitin 2016 kostoja e gjithmbarshme për trajnimin e shërbyesve civil është 80,852.00 €. Me këto resurse financiare, do të mbulohet trajnimi i së paku 2.850 (15%) shërbyesve civil në vitin buxhetor 2016. Kostoja për shërbyesit civil për Planin e Veprimit trevjeçar llogaritet bazuar në BK ekzistues dhe është 214.352,00 €.</p>

	<p>Me këto resurse financiare, kostot për trajnimin e së paku 8.550 shërbyesve civil do të jenë të mbuluara për periudhën e ardhshme trevjeçare.</p> <p>Financimi nga BE-ja (IPA) apo nga donatorë të tjerë ndërkombëtarë do të jetë e mirëpritur. Në momentin e miratimit të këtij Plani të Veprimit, resurset e mundshme financiare ndërkombëtare nuk janë ende në dispozicion. Sipas Objektivit 14 të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike (2015-2020) dhe Planit të Veprimit për Modernizimin e Administratës Publike (2015-2017) numri i shërbyesve civil të trajnuar duhet të rritet për 5% nga 19.000 çdo vit. BK për mbulimin e këtyre shpenzimeve nuk është aprovuar ende. Nëse aprovohet, aktivitetet e propozuara në këtë Plan të Veprimit do të ndryshohen në mënyrën e duhur.</p>
10.	<p>Rekomandojmë që dokumenti i propozuar i strategjisë të aprovohet nga Qeveria, apo nëse mjafton, të aprovohet nga Ministria:</p> <p>Për shkak të rëndësisë këto dy dokumente strategjike duhet të miratohen së bashku nga Qeveria e Republikës së Kosovës në tre mujorin e parë të vitit 2016.</p>
11.	<p>Koha kur drafti i Planit të Veprimit do të dërgohet tek ZKM-ja për shqyrtim në takimin qeveritar apo për shqyrtim para miratimit nga Ministria:</p> <p>Projekti i Planit të Veprimit do të dërgohet tek ZKM-ja, për shqyrtim në fillim të vitit 2016.</p>

1. Hyrje

Dokumenti i propozuar ka për qëllim përmirësimin e kornizës ekzistuese për nëpunësit civil. Republika e Kosovës është duke u përballur me ndryshime të konsiderueshme që ndërlidhen me funksionimin e sundimit të ligjit, demokracisë dhe integritit në BE. Të gjitha këto aktivitete kërkojnë kapacitete përkatëse të nëpunësve civil. Zhvillimi i vazhdueshëm i këtyre kapaciteteve do të jetë prioritet i "Strategjisë për Trajnimin e Nëpunësve Civil, " në periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2020 (5 vite).

Krijimi i një mase kritike të profesionistëve të trajnuar me njohuri dhe aftësi të duhura do ta çojë Kosovën drejt demokracisë efikase dhe integritit në Bashkimin Evropian. Në mënyrë që të mundësohet zbatimi efikas i saj nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, Qeveria ka hartuar gjithashtu Planin përkatës të Veprimit.

Në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Trajnimin e Nëpunësve Civil Publik (STNC) janë detajuar të gjitha aktivitetet që duhet të ndërmerren në mënyrë që të arrihen objektivat e përcaktuara në Strategji.

Ky plani i veprimit identifikon gjithashtu institucionet kryesore, treguesit e suksesit, masat e progresit, koston financiare të veprimeve dhe orareve relevante për zbatimin e secilit veprim. Identifikimi i këtyre veprimeve bëhet në bashkëpunim me institucionet kryesore, bartësit e Strategjisë për Trajnimin e Nëpunësve Civil 2016-2020:

- Ministria e Administratës Publike, Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil (MAP, DASHC) - institucioni kryesor për koordinimin e Planit të Veprimit;
- Instituti i Kosovës për Administratën Publike (IKAP) - institucioni kryesor për zbatimin e Planit të Veprimit;
- Zyra e Kryeministrit, Zyra për Planifikim Strategjik (ZKM, ZPS);
- Ministria e Financave (MF);

- Ministria e Integrimit Evropian (MIE);
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL);
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT);
- Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK).

Ministritë dhe institucionet qeveritare të sipërpërmendura kanë emërtuar anëtarë të Grupin të Veçantë Punues Ndërmintor për Përpilimin e Strategjisë për Trajnimin e Nëpunësve Civil dhe Planit të Veprimit për këtë strategji sipas:

- Vendimit të Sekretarit të Përhershëm të MAP-it, datë 3 nëntor 2014, Nr. 5693, dhe
- Vendimit të Sekretarit të Përhershëm të MAP-it, datë 9 nëntor 2015, Nr. 107.

Implementimi i këtij dokumenti do të kërkonte financim nga Buxheti i Kosovës (më tutje në këtë dokument BK). Në BK-në e aprovuar për vitin 2016 kostoja e gjithmbarshme për trajnimin e nëpunësve civil është **80,852.00€**. Me këto resurse financiare, do të mbulohet trajnimi i së paku **2.850** nëpunësve civil në vitin buxhetor 2016.

Kostoja për nëpunësve civil për Planin e Veprimit trevjeçar llogaritet bazuar në BK ekzistues dhe është **214.352,00€**. Me këto resurse financiare, kostot për trajnimin e së paku **8.450** nëpunësve civil do të jenë të mbuluara për periudhën e ardhshme trevjeçare.

Financimi nga BE-ja (IPA) apo nga donatorë të tjerë ndërkombëtarë do të jetë e mirëpritur. Në momentin e miratimit të këtij Plani të Veprimit, resurset e mundshme financiare ndërkombëtare nuk janë ende në dispozicion.

Sipas Objektivit 14 të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike (2015-2020) dhe draft Planit të Veprimit për Modernizimin e Administratës Publike (2015-2017) numri i nëpunësve civil të trajnuar duhet të rritet për 5% nga 19.000 çdo vit. BK për mbulimin e këtyre shpenzimeve nuk është aprovuar ende. Nëse aprovohet, aktivitetet e propozuara në këtë Plan të Veprimit do të ndryshohen në mënyrën e duhur.

2. Periudha kohore për planin e propozuar të veprimit (3 vite)

Plani i veprimit për trajnimin e nëpunësve civil do të zbatohet gjatë periudhës kohore 2016 – 2018, përkatësisht gjatë tri viteve.

Periudha kohore është përcaktuar sipas Nenit 9 të Udhëzimit Administrativ – UA nr. 02/2012 i Qeverisë së Kosovës.

Zbatimi i dokumentit kryesor, përkatësisht Strategjisë për Trajnimin e Nëpunësve Civil, është përgatitur për periudhë 2016-2020 - pesë vite.

Pas vlerësimit të planit të veprimit do të përgatitet plani i rishikuar për periudhën kohore 2017-2019.

3. Objektivat e strategjisë

Plani i Veprimit përmban pesë (5) objektiva strategjike të përcaktuar sipas Strategjisë (STNC). Objektivat kyç strategjik të Strategjisë së re për Trajnimin e Nëpunësve Civilë janë:

- Objektivi 1): Ngritja e nivelit të profesionalizmit në shërbimin civil.
- Objektivi 2): Ngritja e nivelit të njohurisë së përgjithshme dhe specifike që nevojitet për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian.
- Objektivi 3) :Ngritja e nivelit të shërbimeve administrative që plotësojnë nevojat e qytetarëve.
- Objektivi 4): Ngritja e nivelit të përdorimit të teknologjisë moderne të informacionit në punën e përditshme të nëpunësit civil.

- *Objektivi 5):* Centralizimi i burimeve financiare për zbatimin e strategjisë

Deri në fund të vitit 2018, siç është theksuar në Strategjinë e trajnimeve për nëpunësit civil vlerësimi i fizibilitetit të aktiviteteve të përcaktuara dhe përditësimi i planit do të ndodh në fund të çdo muaji kalendarik.

4. Raportimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit

Vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve dhe koordinimi dhe monitorimi i tyre do të bëhet nëpërmjet mekanizmave që janë identifikuar dhe shpjeguar në mënyrë të qartë në këtë Plan të Veprimit.

Si institucione kryesore, të cilat janë drejtpërdrejtë përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit, janë MAP, DASHC dhe IKAP.


Në mënyrë që të sigurohet koordinimi i arritjes së pesë (5) objektivave nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara nga Plani i Veprimit, Qeveria e Kosovës emëron një koordinator për secilin objektiv. Institucionet koordinuese për pesë (4) objektivat janë:

- ✓ Koordinator i objektivit 1 – MAP, DASHC (Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil)
- ✓ Koordinator i objektivit 2 – MIE (Departamenti Përgjegjës për Reformën e Administratës Publike)
- ✓ Koordinator i objektivit 3 – MAP, DL (Departamenti Ligjor)
- ✓ Koordinator i objektivit 4 – MAP, ASHI (Agjencia për Shoqërinë e Informacionit)
- ✓ Koordinator i objektivit 1 – MAP, DASHC (Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil)

DASHC/MAP, është koordinatori kryesor për këtë Plan të Veprimit, dhe IKAP, si institucioni kryesor ekzekutiv për këtë Plan të Veprimit, raportojnë një herë në vit – deri në fund të muajit mars të çdo viti – tek Ministri i Administratës Publike. Koordinatorët duhet të përgatisin vlerësimin vjetor të aplikimit të këtij dokumenti strategjik dhe të raportojnë tek ministri përgjegjës për Administratën Publike. Afati i fundit për përgatitjen e raportit vjetor është 31 marsi i çdo viti. Kostot e trajnimit – për implementimin e të pesë objektivave strategjike dhe të Planit të Veprimit 2016 -2018 – do të balancohen në raportin vjetor për vitin paraprak. Duke u bazuar në këto raporte nga të gjithë koordinatorët, DASHC-ja/MAP-i do t'i propozojnë Ministrit të Administratës Publike planin e ri vjetor të punës për implementimin e kësaj strategjie dhe Planit të Veprimit. Ministri do të raportojë çdo vit tek Qeveria dhe Komisioni për Modernizim të Administratës Publike (Komisioni RAP i mëhershëm). Qeveria mund të vendosë që institucionet buxhetore me buxhet për trajnime, të cilat kanë nevoja specifike për trajnime për shërbyesit e tyre civil, të centralizojnë buxhetet e tyre ekzistuese duke i transferuar ato në llogarinë buxhetore të IKAP-it.

Pas verifikimit të raporteve të pranuar, Ministri i Administratës Publike do t'i raportojë Qeverisë së Kosovës.

Tabela 1: Formulari i Raportimit mbi zbatimin e Planit të Veprimit



5. Plani i veprimit (tabela)

- Përmbajtja e Planit të Veprimit është përgatitur në formë tabelore.
- Në Planin e Veprimit janë paraqitur pesë (5) objektiva dhe nën-objektivat
- Plani i Veprimit përmban veprime, masa dhe nën-masa konkrete që janë të nevojshme për zbatimin e strategjisë.
- Në Planin e Veprimit janë paraqitur rrjedhat e rekomanduara të veprimit.
- Plani i Veprimit përmban indikatorët në nivel të objektivave specifike.
- Në tabelën e Planit të Veprimit janë caktuar institucionet përgjegjëse për secilin veprim dhe treguesit e suksesit, si dhe periudha për të gjitha aktivitetet.
- Në tabelën e fundit të Planit të Veprimit janë paraqitur kostot financiare për vit, dhe burimet financiare për secilin aktivitet.

Kjo pjesë e Planit të Veprimit do të ishte shumë e rëndësishme edhe për vlerësimin. Metoda e llogaritjes së kostove dhe përshkrimi i kostove janë bashkangjitur në Shtojcën 1 të Planit të Veprimit. Në tabelën e Planit të Veprimit është llogaritur kosto financiare për çdo vit, totali për tre vitet, dhe burimet financiare për secilin aktivitet. Totali vjetor për koston e Planit të Veprimit është në përputhshmëri me buxhetin e adoptuar të Kosovës (BK): 214.352,00 EUR (127.000,00 EUR për pagat bruto të stafit të IKAP-it, 80.352,00 për mallra dhe shërbime që nevojiten për trajnime, dhe 6.500,00 EUR për shpenzime komunale). Totali i kostos për Planin e Veprimit tre vjeçarë, është 241.056. EUR.

Kosto sipas përqindjes së objektivave:

- 46% e kostos totale e mbulon zbatimin e Objektivit 1,
- 24% e kostos totale e mbulon zbatimin e Objektivit 2,
- 10% e kostos totale e mbulon zbatimin e Objektivit 3 dhe
- 20 % e kostos totale e mbulon zbatimin e Objektivit 4, ndërsa Objektivit 5 nuk ka kosto.

Në tre vitet e ardhshme do të trajnohen 8.550 nëpunës civilë. Nga numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë, që është 19.000 , në baza vjetore do të trajnohen 15 % ose 2850 nëpunës civilë. Në baza vjetore, sipas _Objektivit 1 trajnohen 1.311 , sipas Objektivit 2 trajnohen 456, sipas Objektivit 3 trajnohen 285 dhe _sipas Objektivit 4 trajnohen 570 shërbyes civilë.

Objektivi 1): Ngritja e nivelit të profesionalizmit në shërbimin civil								
Qëllimi: NGRITJA E MËTEJSHME E NIVELIT TË PROFESIONALIZMIT NË SHËRBIMIN CIVIL								
Objektivi specifik				Indikatorët në nivel objektiv specifik			2016-2018 PRODUKTI 3 VJET	
1. Trajnimet hyrëse për nëpunësit civil të cilët fillojnë për herë të parë marrëdhënie punë në Shërbimin Civil				Nëpunësit civil të trajnuar sipas objektivit 1			6,9 % CST	
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Kostoja për vite			Kostoja totale për aktivitetet	Burimi i financave
				2016	2017	2018		
1.1. Trajnime për etiken, integritetin dhe transparencën në Administratën Publike (AP)	2016 2017 2018	IKAP	MAP IRK	6,654	6,654	6,654	19,962	BK
1.2. Trajnime për Legjislacionin e funksionimit dhe organizimit të shtetit	2016 2017 2018	IKAP	MAP IRK	6,380	6,380	6,380	19,140	BK
1.3. Trajnim për administrimin e punës në zyre	2016 2017 2018	IKAP	MPA IRK	4,390	4,390	4,390	13,170	BK

Plani i Veprimit 2016-2018 - për Zbatimin e Strategjisë për Trajnimin e Nëpunësve Civil

Objektivi specifik				Indikatorët në nivel objektiv specifik				
2. Zhvillimi i kapaciteteve të nëpunësve civil përmes trajnimeve profesionale dhe ngritjes në karrierë				Nëpunësit civil të trajnuar sipas objektivit 1				
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Kosto financiare			Kostoja totale për aktivitetet	Burimi i financave
				2016	2017	2018		
2.1. Trajnim për planifikim	2016	IKAP	Të gjitha	1,811	1,811	1,811	5,433	BK

dhe menaxhim Lidership dhe menaxhim (planifikim) Trajnim për lidership dhe menaxhim	2017 2018		organizata t buxhetore					
2.2. Trajnim për vlerësimin e ndikimit rregullativ dhe hartim të koncept dokumenteve	2016 2017 2018	IKAP	MAP/ZK M	2,610	2,610	2,610	7,830	BK
2.3. Trajnim për komunikim me publikun	2016 2017 2018	IKAP	MAP/ZK M	1,250	1,250	1,250	3,750	BK
2.4. Trajtime për hartim, zbatim, kordinim dhe monitorimit të politikave	2016 2017 2018	IKAP	IRK	1,911	1,911	1,911	5,733	BK
2. 5. Trajtime për menaxhimin e burimeve njerëzore, planifikim të personelit, caktimin e objektivave, përshkrimin e detyrave të punës, dhe vlerësim të rezultateve në punë	2016 2017 2018	IKAP	MAP/DA ShC	2,120	2,120	2,120	6,360	BK
2.6. Trajnimi për krijimin dhe riorganizimin e strukturave organizative të instituconeve në Administratën Publike	2016 2017 2018	IKAP		2,115	2,115	2,115	6,345	BK
2.7. Trajnim për trajner për politikat e burimeve njerëzore	2016 2017 2018	IKAP		1,098	1,098	1,098	3,294	BK
2.8. Trajnim për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset	2016 2017 2018	IKAP		1,900	1,900	1,900	5,700	BK
2.9. Trajnim për planifikimin	2016	IKAP		1,130	1,130	1,130	3,390	BK

e buxhetit, menaxhimin e financave publike dhe auditim të brendshëm	2017 2018							
2.10. Trajnim për prokurimin publik	2016 2017 2018	IKAP		1,911	1,911	1,911	5,733	BK
2.11. Trajnim për mbrojtën e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike/zyrtare	2016 2017 2018	IKAP		1,911	1,911	1,911	5,733	BK
TOTALI - OBJEKTIVI 1				37,191 (46 % e BK vjetor për 2016)	37,191 (46 % e BK vjetor për 2017)	37,191 (46 % e BK vjetor për 2018)	(46 % e buxhetit të përgjithshëm për trajnime)	BK

Objective 2): Ngritja e nivelit të njohurive të përgjithshme dhe specifike që nevojiten për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian

Qëllimi: ZHVILLIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN E DETYRIMEVE NGA MSA-së DHE KORNIZA PËR ANËTARËSIMI NË BASHKINË EVROPIANE

Objektivi specifik	Indikatorët në nivel objektivi specifik			2016 -2018 PRODUKTI 3 VJET				
1.Zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve për procesin e integritit evropian, me fokus në planifikim të politikave, përafrim ligjor, programim të asistencës, vlerësim dhe monitorim.	1.Numri i nëpunësve civil të trajnuar sipas aktiviteteve në kuadër të objektivit.			3,6 % NCT				
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegj	Institucioni mbështetë	Kostoja për vite			Kostoja totale për	Burimi i financave
				2016	2017	2018		

		ës	tës				aktivitet	
1.1. Trajnim për përafrim të legjislacionit kombëtar me legjislacionin (Acquis-në) e BE-së	2016 2017 2018	MIE	IKAP	3,520	3,520	3,520	10,560	BK
1.2. Trajnim për aspektet juridike dhe legislative të MSA-së (dispozitat) - trajnime te veçanta	2016 2017 2018	MIE	IKAP	2,876	2,876	2,876	8,628	BK
1.3. Trajnim për zbatim të politikave në kuadër të MSA-së	2016 2017 2018	MIE	IKAP	2,620	2,620	2,620	7,860	BK
1.4. Trajnim për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të MSA-së	2016 2017 2018	MIE	IKAP	2,644	2,644	2,644	7,932	BK
1.5. Trajnimi i zyrtarëve për fushën e përafrimit të legjislacionit vendor me legjislacion të BE-së në mënyrë specifike për fusha/kapituj të veçantë të <i>acquis</i>	2016 2017 2018	MIE	IKAP	3,772	3,772	3,772	11,316	BK
1.6. Trajnim për asistencë të jashtme dhe monitorimin, vlerësimin e projekteve të asistencës së BE-së.	2016 2017 2018	MIE	IKAP	2,972	2,972	2,972	8,916	BK
TOTALI - OBJEKTIVI 2				19,404 (24 % e BK vjetor për 2016)	19,404 (24 % e BK vjetor për 2017)	19,404 (24 % e BK vjetor për 2018)	(24 % e buxhetit të përgjithshëm për trajnime)	BK

Objective 3): Ngritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve administrative

Qëllimi: PËRMIRËSIM I NIVELIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE QË PLOTËSOJNË NEVOJAT E QYTETARËVE

Objektivi specifik

Indikatorët në nivel objektiv

				specifik			2018 PRODUKTI 3 VJET	
1. Ngritja e kapaciteteve së nëpunësve civil në zbatimin e procedurave administrative				Nëpunësit civil të trajnuar sipas objektivit 3			1,5% NCT	
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Kostoja për vite			Kostoja totale për aktivitet	Burimi i financave
				2016	2017	2018		
1. Trajnim për nëpunësit civil në zbatimin e Ligji për procedura te përgjithshme administrative	2016 2017 2018	IKAP	MAP/IRK	2,900	2,900	2,900	8,700	BK
2. Trajnim për zbatimin e shenjave unike të klasifikimit të dokumenteve	2016 2017 2018	IKAP	MAP/IRK	2,485	2,485	2,485	7,485	BK
3. Trajnim për ofrimin e shërbimeve për qytetaret dhe bizneset (me fokus të veçante për nivelin komunal)	2016 2017 2018	IKAP	MAP/IRK	2,700	2,700	2,700	8,100	BK
TOTALI - OBJEKTIVI 3				8,085 (10 % e BK vjetor për 2016)	8,085 (10 % e BK vjetor për 2017)	8,085 (10 % e BK vjetor për 2018)	(10 % e buxhetit të përgjithshëm për trajnime)	BK

Objektivi 4): Përdorimi i teknologjisë se avancuar të informacionit në punën e përditshme të nëpunësit civil

Qëllimi: NGRITJA E NIVELIT TË PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË SE AVANCUAR TË INFORMACIONIT NË PUNËN E PËRDITSHME TË NËPUNËSIT CIVIL

Objektivi specifik				Indikatorët në nivel objektivi specifik			Caku 2016 2018 PRODUKTI 3 VJET	
1. Trajnim në fushën e TI-se përmes programeve bazike				Nëpunësit civil të trajnuar sipas objektivit 4			3 % NCT	
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Kostoja për vite			Kostoja totale për aktivitet	Burimi i financave
				2016	2017	2018		
1.1. Trajnim në pakon e programeve aplikative Microsoft Office/Licenca Evropiane e Përdorimit të Kompjuterit ECDL (European Computer Driving License)	2016 2017 2018	MAP/ASHI	-	2,695	2,695	2,695	8,085	BK
1.2. Trajnim i nëpunësve civil në - Microsoft Project - Microsoft Visio & - Microsoft Lync	2016 2017 2018	MAP/ASHI	IKAP	2,895	2,895	2,895	8,085	BK
Objektivi specifik				Indikatorët në nivel objektivi specifik				
2. Trajnim në fushën e TI-se përmes programeve të avancuara				Nëpunësit civil të trajnuar sipas objektivit 4				
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Kostoja për vite			Kostoja totale për aktivitet	Burimi i financave
				2016	2017	2018		
2.1. Trajnim në Menaxhim të Sistemeve të Informacionit (Sistemet Inxhinerike, Siguria TI, Biblioteka e Infrastrukturës të teknologjisë së Informacionit)	2016 2017 2018	MAP/ASHI	IKAP	1,990	1,990	1,990	5,970	BK

/ITIL/ dhe e-Qeverisja).								
2.2. Trajnim dhe certifikim nga - CISCO (CCNP, CCNP Security,..) - Rrjetin mikrovalor, - fibër Optik, - Wireless, -VoIP.	2016 2017 2018	MAP/A SHI	IKAP	2,795	2,795	2,795	8,385	BK
2.3. Trajnim për Menaxhim të avancuar (Menaxhimi i përgjithshëm, Menaxhim i Cilësisë, Menaxhim i Projekteve dhe proceseve, Menaxhim Strategjik, Menaxhim Operacional).	2016 2017 2018	MAP/A SHI	IKAP	2,255	2,255	2,255	6,765	BK
2.4. Trajnim i nëpunësve civil për përdorimin e Sistemit të Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ)	2016 2017 2018	MAP/ ASHI	IKAP	3,540	3,540	3,540	8,085	BK
TOTALI - OBJEKTIVI 4				16,170 (20 % e BK vjetor për 2016)	16,170 (20 % e BK vjetor për 2017)	16,170 (20 % e BK vjetor për 2018)	(20 % e buxhetit të përgjithsh ëm për trajtime)	BK

Objektiva 5): Centralizimi i resurseve financiare për zbatimin e Strategjisë

Qëllimi: Sigurimi i mjeteve financiare përmes centralizimit të buxhetit, nga institucionet tjera në IKAP, për zbatimin e Strategjisë për Trajnimin e Nëpunësve Civilë.

Objektivi specifik	Indikatorët në nivel objektivi specifik	Baza/situata aktuale	Caku 2016 -2018			
1. Politikat e centralizimit te buxhetit per trajnimet per nepunesit civil	Politika Dokumenti i nevojshëm për mbulimin e kostove të implementimit të Strategjisë që tejkalojnë aktivitetet e Planit të Veprimit (trajnimet e veçanta)	Faza fillestare	Transferimi i resurseve financiare për trajnime te IKAP			
	Dokumenti duhet nënshkruar në mes institucioneve, të cilat janë koordinatorë të këtij Plani të Veprimit .					
1. Aktivitetet	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Kostoja për vite		
				2016	2017	2018
1. Identifikimi dhe analiza e mjeteve buxhetore për trajnimet e nëpunësve civil në organizatat buxhetore	K1/2016	MAP/MF/IKAP	IRK	00	00	00
2. Hartimi i koncept dokumentit				euro	euro	euro
3. Aprovimi i buxhetit sipas politikës së re të propozuar						

PËRMBLEDHJE

OBJEKTIVAT		INDIKATORËT 2016- 2018		CAKU 2016-2018	
		GJITHSEJ SHCT (SHËRBYES CIVIL TË TRAJNUAR)		% SHCT (Nga gjithsej 19000 shërbyes civil)	
OBJEKTIVI 1	BUXHETI PËR OBJEKTIVIN 1	SHËRBYES CIVIL TË TRAJNUAR		CAKU PËR SHËRBYES CIVIL TË TRAJNUAR NGA GJITHSEJ 19000	
	46% 37,191	2016	2017	2018	GJITHSEJ
		1.311	1.311	1.311	6,9% SHCT
OBJEKTIVI 2	BUXHETI PËR OBJEKTIVIN 2	SHËRBYES CIVIL TË TRAJNUAR		Shërbyes civil të trajnuar nga gjithsej 19000	
	24% 19,404	2016	2017	2018	GJITHSEJ
		684	684	684	3,6 % SHCT
OBJEKTIVI 3	BUXHETI PËR OBJEKTIVIN 3	SHËRBYES CIVIL TË TRAJNUAR		Shërbyes civil të trajnuar nga gjithsej 19000	
	10% 8,085	2016	2017	2018	GJITHSEJ
		285	285	285	1,5 % SHCT

OBJEKTIVI 4	BUXHETI PËR OBJEKTIVIN 4	SHËRBYES CIVIL TË TRAJNUAR		Shërbyes civil të trajnuar nga gjithsej 19000			
	20% 16,170	2016	2017	2018	GJITHSEJ		
		570	570	570	3 % SHCT		
OBJEKTIVI 5	BUXHETI PËR OBJEKTIVIN 5	Faza 1: marrëveshja ndërinstitucionale		Rast për rast në vitin 2016			
	-	Faza 2: Buxheti për trajnime të SHC-ve i centralizuar në llogarinë buxhetore të IKAP-it		Pas vlerësimit vjetor në vitin 2017, 2018			
TOTAL	BUXHETI TOTAL PËR AP 3 VJET	BUXHETI TOTAL PËR VIT		SHËRBYES CIVIL TË TRAJNUAR NGA GJITHSEJ 19000			
	100% 643.056,00 EUR	Paga dhe mëditje	127,000.00€	2016	2017	2018	Total
		Mallra dhe shërbime	80,852.00€	2.850	2.850	2.850	8.550
Shpenzimet komunale	6,500.00€	15% NCT	15% NCT	15% NCT	15% NCT		
	TOTALI	214.352,00€				15% NCT	

